



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.971/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Avokat L.V., me seli në Prishtinë, rruga "...", Kompleksi, kati ..., numër .., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M.B., avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, me seli në Fushë Kosovë, rruga "...", nr..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.281/23 të datës 15.05.2023, të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, jashtë seancës me datës 27.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.281/23 të datës 15.05.2023 të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.281/23 i datës 15.05.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumën prej 117.00 € (njëqind e shtatëmbëdhjetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit Avokat L.V., në bazë të titullit përmbartues - Marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.281/23 të datës 15.05.2023, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, që në emër të detyrimit në të holla të përcaktuar në marrëveshjen e ndërmjetësimit nr. 015/2022 të

datës 27.12.2022, t'ia paguajë kreditorit të përbarimit Av. L.V. shumën në lartësi prej 312.00 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor duke theksuar se numrat e lëndës nga P.nr.280/23 e deri tek P.nr.307/23 të datës 15.05.2023 janë të paqartë, ngase është një vazhdim i procedurave dhe obligimeve që ka marrë kreditori nga kontraktuesit e shërbimeve, e që ende pa përfunduar punën kërkon shpërblimin e pjesshëm. Më tutje ka shtuar se kreditori nuk është drejtuar me ndonjë kërkesë zyrtare apo me ndonjë faturë tek debitori në mënyrë që debitori të jetë i informuar, për më tepër kreditori nuk i ka përmbushur detyrimet e veta ndaj debitorit sipas kontratave dhe autorizimeve që ka marr nga kërkuesit e shërbimeve të avokatisë. Debitori ka theksuar se avokati ka vënë në lajthitje debitorin dhe ndërmjetësuesin duke nënshkruar një marrëveshje të dyshimtë dhe pa efekt juridik. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë prapësimin e debitorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar ndër të tjerash se qëllimi i këtij prapësimi është zvarritja e procedurës përbarimore. Ka shtuar se dokumenti mbi të cilin është lëshuar urdhri përbarimor është marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar i përgatitur dhe lëshuar nga ndërmjetësuesi i licencuar me numër të licencës 58/2011, ku në paragrafin e fundit të marrëveshjes precizohet saktë se ky dokument përmban klauzolën mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes dhe e njëjta ka fuqinë e dokumentit përbarues. Në lidhje me pretendimet e debitorit se këtë marrëveshje nuk e ka nënshkruar personi i autorizuar, ky pretendim nuk qëndron pasi që të njëjtën e ka nënshkruar zyrtari ligjor i debitorit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, si dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguajë shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim konform tarifës së OAK në vlerë prej 234.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore,

(tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata gjeti se dokumenti përbarimor - Marrëveshjen e ndërmjetësimit nr. 015/2022 të datës 27.12.2022 është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit - vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.4, përcaktohen dokumentet përbaruese siç janë: *“marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin;”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumentet përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përbarim i caktuar mbi bazën e titullit përbarimor - Marrëveshja e ndërmjetësimit nr. 015/2022 të datës 27.12.2022, i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.4 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që dokumenti përbarimor është i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 117.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.971/23, datë 27.10.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.